



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 32, pika 32.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr 110-455, të dt. 31.3.2008, të rishikimit të buxhetit për vitin 2008-projektet kapitale, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.9.2008, merr

**V E N D I M**  
**PËR RIDESTINIMIN E MEJTEVE PËR PROJEKTET KAPITALE PËR VITIN 2008**

**Neni 1**

MIRATOHET Vendimi për ridestinim të mjeteve për projektet kapitale për vitin 2008 - pozicioni projekteve kapitale, të miratuara për vitin 2008 nga ana e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**Neni 2**

Qëllimi i Vendimit të cekur nën nenin 1 të këtij Vendimi, është që mjetet e lira, të gjetura pas rishikimit të buxhetit për vitin 2008-projektet kapitale, të ridestinohen brenda programit të investimeve kapitale.

**Neni 3**

Ridestinimi i mjeteve të lira të cekura nën nenin 2 të këtij Vendimi, do të jetë sinë vijim:

- a) nga fondi 010-grant përgjithshëm, destinomi i mjeteve të lira të vihen në dispozicion për projektet e koduara nën nr. 68114 "Projekti i tatimit në pronë", në shumë prej 329.882.10 €;
- b) Nga fondi 021 dhe 022- të hyrat vetanake për vitin 2008 dhe të hyrat e mëparshme, barten për shfrytëzim në projektin e koduar 68088 "Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve me infrastrukturë përcjellëse".

**Neni 4**

Zbatimin e këtij Vendimi do ta bëjë Kryetari i Komunës së Prishtinës.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 400-1408, më 26.9.2008**

**Kryetar i Komunës**  
**Prof.dr. Isa Mustafa**